VENDIM
Nr. 22, datë 11.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "GREEN ENERGY TRADING ALBANIA" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 35, 8 pika 1 germa "a" 9 dhe 13 pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa "g"; neni 8, 10 pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa "a" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "b" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "c" e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti